

V E N D I M

"PËR VENDOSJE SEKUESTRO PREVENTIVE "

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, e përbërë nga:

Gjyqtar : Adriatik Bocaj

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Ramela Skuqi** sot në Tiranë, më datë **28.02.2017**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me Nr.Regj. **Them 333** që i përket :

KËRKUESE T. H. Z.e datelindjes 31.03.19..,perfaqesuar me procure nga avokat Ardian Vishaj me adres:Rr.Panorama.P.16K,ShIII ,Kati II Tirane

PALE E TRETE : Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar me autorizim nga Prokuroria Dritan Reshka

OBJEKTI: Heqjen e e sekuestros preventive mbi te gjitha llogarite ne emer te Shtetases T. H. Z. e datelindjes 31.03.19.. ,te urdheruara me vendimin nr.1332 akti date 24.10.2016te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane.

BAZA LIGJORE : Nenet 274/3i K Pr Penale

Gjykata pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi, administroi provat dhe degjoi kerkesat perfundimtareve te paleve, te cilet kerkuan:

Perfaqesuesin e kerkueses T. Z.T. Z.avokat Ardian Visha:

Pranimin e kerkese duke hequr sekuestron preventive te vendosura ne llogarite ne emer te kerkueses

Prokuroria Dritan Reshka

Pranimin kekreses per heqjen e sekuestros preventive mbi te gjitha llogarite ne emer te Shtetases T. H. Z. e datelindjes 31.03.1948 .

Gjykata si e bisedioji ceshtjen ne teresi:.

VEREN

Kerkuesia T. Z.me kerkese drejtuar gjykates bazuar ne neni 274/3 te Kodit Procedures Penal kerkon: Heqjen e e sekuestros preventive mbi te gjitha llogarite ne emer te Shtetases T. H. Z. e datelindjes 31.03.19.. ,te urdheruara me vendimin nr.1332 akti date 24.10.2016te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Nga hetimi gjyqesor rezultoi se :

Gjykata e Rrethi Gjyqesor Tirane me vendimin nr.1332 akti date.24.10.2016 ka vendosur:

“Pranimin e kerkeses.

Vendosjen e sekuestros preventive mbi te gjitha llogarite ne emer te Shtetases T. H. Z. e datelindjes 31.03.19.. .

Kundër vendimit për vënien e sekuestros cilido që ka interes mund të bëjë ankim.

Kërkesa e ankimit paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë.

Kërkesa paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin”

Gjykata e Apelit Tirane me vendimin e dates 15.11.2016 ka urdheruar:”Miratimin e vendimit nr.1332 akti date.24.10.2016 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane”

Ky vendim eshte vendosur per shkakun se:

Seksioni për Pastrimin e Parave ne Drejtorine Vendore te Policise Tirane ka administruar informacion se shtetasi F. Z., i datëlindjes 25.12.19.., lindur në Kuçovë dhe banues ne Tirane është arrestuar ne date 25.02.2016 për llogari të autoriteteve italiane për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike me qëllim ekstradimit e tij drejt Italisë. Per kete shtetas ka patur edhe me pare ceshtje te regjistruara ne ngarkim te tij per pastrim parash.

Nga verifikimet qe jane bere per nenen e personit te mesiperem, konkretisht shtetases T. Z.T. Z.ka rezultuar se date 10.10.2016 shtetasja T. Z.T. Z.ka lidhur një kontratë kapari me nr.rep / kol ..., sipas të cilës ka marrë kapar në shumën 135,000 Euro nga shtetasi G. S. K.i datëlindjes 21.06.19.. për shitjen e një vile pjesë e kompleksit "White House" e ndodhur në Lundër, Tirane. Kjo pasuri eshte vrene dakord te shitet me nje cmim ne total

prej 515,000 Euro. Në kontratë është parashikuar se pjesa tjetër prej 380,000 Euro do të likujdhohet në momentin që dpo te dale e freskuar nga ZVRPP-ja Tiranë, kone ne te cilen do te lidhet edhe kontrata e shitjes. Në të njëjtën datë pra me 10.10.2016 shtetasi R. E. B., i biri i shtetases T. Z.T. Z.dhe si perfaqesues i saj emëruar sipas një prokure të posaçme, ka kërkuar të tërheqë shumen prej prej 135,000 Euro cash nga llogaria e T. Z..

Nga verifikimi e metejshme per shtetasen T. Z.ka rezultuar se ka disa raportime të kontratave noterial e për periudhën në vijim 2014 - 2016. Në datë 10.3.2014 ka dhënë hua shumën 21,000 Euro tek huamarrësi S. L. D.i datëlindjes 01.05.19.. (kontrata ..., noter Majlinda Lleshi). Në datë 10.9.2015 ka dhënë hua shumën 13,000 Euro tek huamarrësi A. G. F., i datëlindjes 15.01.19.. (kontrata ..., notere Majlinda Lleshi). Në datë 3.10.2015 si individ ka shitur

apartament me çmim 126,500 Euro, nga të cilat janë paguar jashtë zyrës noteriale 89,200 Euro dhe pjesa tjetër 37,300 Euro është paguar nepermjet llogarisë së noterit ku pale blerëse është K. S. P.. Në datë 11.11.2015 sipas kontratës së huasë (818/234) ka dhënë hua shumën 20,000 Euro tek huamarrësi Z. Z. M., kontratet e nenshkruar prane noterit Gentjan Kërcuku. Në datë 26.11.2015 ka dhënë hua shumën 13,000 Euro tek huamarrësi A. G. F. me përshkrim "kthim huaje" sipas deklaratës noteriale nr.... hartuar para Noterit Gentjan Kërcuku. Në datë 22.02.2016 ka dhënë hua shumën 15,000 Euro tek huamarrësi F. M. V.me afat deri 15.9.2016 , kontrate me numer ... nenshkruar prane Noter Gentjan Kërcuku. Në datë 14.4.2016 shtetasja T. Z.ka dhene si individ hua shumën 15,000 Euro tek huamarrësi F. M. V.sipas kontrates me nr. ... hartuar para Noter Gentjan Kërcuku.

Nga verifikimet e kryera per shtetasin R. B.apo Z. (djali i shtetase s T. Z.) rezulton se ky shtetas ka vepruar në llogarinë e shoqërisë "F... C..." shpk, konkretisht ne date datë 27.01.2014 ka tërhequr 10,000 Euro me çek nr. 300019, datë 04.02.2014 dhe ka derdhur shumën 1,135,000 lek në llogarinë e shoqërisë. Ka një raportim të një kontrate noteriale si individ pasi ne date 26.11.2015 ky shtetas R. B.ka blerë apartament me çmim 128,000 Euro, me deklarinimin se shumata do të likujdhohet në llogarinë e shoqërisë (kontrata ..., noter Gentjan Kërcuku).

Po keshtu nga verifikimet e bera per shtetasen R. Z., te bijen e shtetase s T. Z..rezulton se kjo shtetase ka vepruar në emër të shoqërisë "F... C..." shpk duke lidhur kontrata shitje edhe për periudhën vijuese. Janë 42 raportim e të transaksioneve noteriale të lidhura për shoqërinë për periudhën 2014-2016 dhe ka edhe dy raportime ku ajo shfaqet në transaksione noteriale si individ. Kjo shtetase ka blere ne date 03.10.2015 apartament nga shoqëria "F... C..." shpk me çmim 65,000 Euro dhe shoqëria në këtë kontratë përfaqësohet nga shtetasi R. B.apo Z., vella i shtetase s R. Z.. Në datë 19.10.2015 kjo shtetase s ka blere si individ nje garazh me

nr.A8, sipërfaqe 16.1m², me adresë Rruga "... " me çmim 7,000 Euro tek shitësi shoqëria "A... I... C...(A.Le.) Shpk.

Ne te tilla rrethana nisur nga fakti qe shtetasi F. Z. është arrestuar ne date 25.02.2016 për llogari të autoriteteve italiane për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike me qëllim ekstradimin e tij drejt Italisë, nëna e tij T. Z. është administrator dhe ortakë e shoqërisë "F... K..." shpk dhe e përfshirë në kryerjen e shumë transaksioneve financiare, përfshirja e djalit të saj Romeo Zekaj dhe paisja e tij me prokurë për të vepruar në emer dhe llogari të shoqërisë si edhe përfshirja e vajzës së saj R. Z. në transaksionet e kryera nga shoqëria "F... K..." duke bërë edhe transaksione me këto shoqëri brenda rrethit familjar krijon dyshime të arsyeshme për elemente të veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale", të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Perfaqesuesi i kerkueses shpjegoi se; Thua jse teresia e plote e vendimit gjyqësor sekuestrues përbehet nga një curriculum raportesh të karakterit financiar që jo vetëm kanalizohen në rrugën e duhur ligjore të kryerjes nëpërmjet sistemit bankar dhe akteve noteriale përkatëse, por edhe kanë qenë të kontrolluara me parë gjyqësisht në legjitimitetin e tyre si dhe në korrektesën e të njëjtit subjekt të hetuar nga e njëjta Prokurori, shtetases T. Z..

Mbi këto këto të vertet, konkludojmë pamundësin absolute ligjore të ruajtjes së vazhdimësisë goditëse proceduese të Prokurorisë, kundër shtetases T. Z., për fakte, ngjarje e interpretime që tashmë përbejnë gjë të gjykuar.

Mbi këto veprim të karakterit financiar nuk ka absolutisht asnjë dyshim parregullsie ligjore. Jo vetëm që ai pason një kontratë të ligjshme mes palëve, por edhe çdo hallkë tjetër e veprimëve përkatëse civile dëshmon për parsterinë e transaksionit dhe korrektesën absolute legale të tij. Bazuar ssa me sipër kërkojmë, Heqjen e e sekuestros preventive mbi të gjitha llogaritë në emer të Shtetases **T. H. Z. e datelindjes 31.03.19..**, të urdheruara me vendimin nr.1332 akti date 24.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.

Prokurori në shpjegimet e tij në seance gjyqësore tha : *Sqaroj që konteksti i sekuestros preventive mbi këto llogari se pari kanë qenë dyshimet që lidhen me djalin e shtetases T.a Z. duke pasur parasysh që arsyeja e këtij transaksioni nuk kishte lidhje me veprimet e djalit të saj nga verifikimet që i është bërë atij transaksioni duke patur parasysh pala që ka bërë pagesën veprimi juridik dhe destinacioni i parave nuk rezultojnë që ky transaksion të ketë dyshim për një aktivitet të mundshëm pastrimi parash mendoj se kërkesa duhet pranuar në kushtet kur ky transaksion nuk ka lidhje në dyshimet e ngritura hetimi është përqendruar tek shtetasi F. Z.. Do ju ve në dispozicion një kopje të akteve që ka të bëjë me procesverbalin për marrjen e të dhënave nga persona që tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit të datës 30.01.2017 të dhënë nga shtetesia T. Z..*

Në nenin 274/3 të Kodit të Procedure s Penale parashikohet se :*Kur ndryshojne kushtet e zbatimit,gjykata,me kerkesen e prokurorit ose te te interesuarit ,heq sekuestron.”*

Gjykata duke pare sa siper dhe mbeshtetur ne kerkesen e prokurorit per pranimin e kerkeses per heqjen e Heqjen e e sekuestros preventive mbi te gjitha llogarite ne emer te Shtetases **T. H. Z. e datelindjes 31.03.19.. ,te urdheruara me vendimin nr.1332 akti date 24.10.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ,duhet ta heqi sekuestron preventive te vendosura ne llogarit e kerkueses T. Z.**

Sa siper u provua nga theniet perfaqesuesit te kerkueses te prokurores dhe provat e administruara ne séance gjyqesore.

PER KETO ARSYE

Gjyakata e bazuar ne nenin 274/3 te K.Pr.Penal

V E N D O S I

Pranimin e kerkeses.

Heqjen sekuestros preventive mbi te gjitha llogarite ne emer te Shtetases T. H. Z. e datelindjes 31.03.19..

Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.

Kundër vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane

- **U shpall sot më datë 28.02.2017, në Tiranë.**

SEKRETARE

Ramela Skuqi

GJYQTAR

Adriatik Bocaj